



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:185521

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826531

C.nr. 578/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar T.G, kundër të paditurit S (R) B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, me bazë juridike kompensimin e dëmit material, vlera objektit të kontestit 280.78 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, më datën 14.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë.

II. DETYROHET i padituri S (R) B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, që në emër të dëmit material ta kompensojë paditësen K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë në shumën prej 280.78 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data 22.12.2020 (data e parashtrimit të padisë), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri S (R) B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë për taksën gjyqësore, paditëses K me seli në Prishtinë – Distrikti në Gjakovë, të ja paguajë shumën prej 20.00 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja K Distrikti në Gjakovë, më datën 22.12.2020, në këtë gjykatë ndaj të paditurit S (R) B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material në shumën prej 280.78 euro. E njëjta, si në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare përmes të autorizuarit të saj, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, me propozimin që gjykata të bëjë shqyrtimin e provave dhe pas shqyrtimit të provave kërkesëpadinë e saj ta aprovojë në tërësi si të bazuar, me arsyetimin se me të gjitha provat e

administruara nga gjykata gjatë shqyrtimit kryesor, kërkesëpadia e saj është provuar si e themeltë.

Paditësja më tej ka shtuar se dëmi në vlerën prej 280.78 euro është shkaktuar nga i padituri si pasojë e kryerjes së veprës penale nga neni 320 të KPRK-së. I padituri me aktgjykimin me numër P.nr.387/17 i datës 20.11.2018, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, i cili është bërë i plotfuqishëm më datën 26.12.2018, i padituri është shpallur fajtor në të gjitha pikat e aktakuzës. Lartësia e dëmit vërtetohet në bazë të faturës së kalkulimit të datës 15.05.2017 dhe faturës me numër DGJHP176782 të datës 15.05.2017. Llogaritja e dëmit është bërë në bazë të pajisjeve të cilat i ka pasur i padituri në momentin e keqpërdorimit të energjisë elektrike dhe është llogaritur për 6 muaj në mënyrë retroaktive e që rezulton të jetë edhe vlera e kërkesëpadiisë në pajtueshmëri me Rregulloren për Procedurën për Identifikim dhe Parandalim të Shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, neni 14.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së ushtruar, ka ftuar të paditurin që të paraqet përgjigjen e tij në padi, i padituri me datën 19.09.2022, ka paraqitur përgjigje në padi. I njëjti ka theksuar se: nuk janë të vërteta thëniet – pretendimet e paditëses në padi, pasi që ai nuk e ka ditur se çfarë dëmi i ka shkaktuar paditëses dhe nuk e ka ditur se çfarë dëmi duhet ti kompensojë paditëses. Ka shtuar se, sa i përket datës 12.05.2017 nuk i ka shkaktuar dëm paditëses, pastaj shtrohet pyetja se si ka ardhur në përfundim paditësja që është dëmtuar në shumë prej 280.78 euro, kur nuk është bërë asnjë ekspertizë që do të vërtetonte që paditësja është dëmtuar në këtë shumë, po ashtu, me tej ka theksuar që nuk ka pasur se si të shpenzojë apo ta dëmtojë KEDS-in për shumën që po e kërkon, përderisa familja e tij nuk ka qenë në Kosovë. Më tej ka theksuar që paditësja shumën që po e kërkon dhe e ka futur në faturë mendon që është e kundërligjshme, andaj në mungesë të bazës ligjore dhe të provave konsideron që paqdia nuk është në rregull, nuk është e plotë dhe jo e argumentur, jo reale dhe si e tillë inekzistente. Po ashtu, nga të gjitha të cekura më lartë, konsideron që gjykata duhet që padinë ta refuzojë si të pabazuar dhe të pa argumentuar në fakte dhe në prova relevante, apo tja kthejë paditësit në plotësim me prova tjera dhe pastaj të i'a dërgojë për përgjigje. Ndërsa gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar se orëmatësi nuk është në emrin e tij dhe nuk e pranon këtë borxh, por në procedurë penale e kamë pranuar fajësinë sepse nuk kam dashur që të hy në procedura tjera gjyqësore.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 06.06.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: aktgjykimin P.nr.387/17, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, të datës 20.11.2018, i cili është bërë i plotfuqishëm më datën 26.12.2018; faturën e kalkulimit me id. të rastit 118866 të datës 15.05.2017; faturën me nr. DGJHP176782 të datës 15.05.2017.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se i padituri S (R) B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, ishte konsumator i kompanisë KEDS. Gjithashtu nuk ishte kontestues as fakti se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë në nenin 320 të KPRK-së, në kohën e kryerjes së veprës penale. Po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm.

Në këtë çështje kontestimore, kontestues është fakti se a ekziston obligimi i të paditurit që paditëses t'ia kompensojë dëmin material sipas shumës së kërkesëpadisë së paditëses dhe se nëse ekziston ky dëm cila është lartësia që duhet i padituri të ia kompensojë paditëses.

Me administrimin e aktgjykimit P.nr.387/2017, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, i cili është bërë i plotfuqishëm më datën 26.12.2018, gjykata e ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale nga neni 320 të KPRK-së, në kohën e kryerjes së veprës penale dhe se dëmi i shkaktuar nga ana e të paditurit në drejtim të paditëses sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është 280.78 euro. Gjykata i fali besimin kësaj prove tërësisht pasi që i njëjti është aktgjykim i plotfuqishëm dhe se në lëmin penale për këtë çështje përbën *res judicata*.

Me administrimin e faturës së kalkulimit me id. të rastit 118866 të datës 15.05.17, gjykata vërtetoi faktin se energjia e shpenzimit të paautorizuar nga konsumatori R.L.B është 4,712 KWh.

Me administrimin e faturës me nr. DGJHP176782 të datës 15.05.2017, gjykata vërtetoi faktin se vlera totale e borxhit të të paditurit ndaj paditëses është 280.78 euro. Gjykata ia fali besimin tërësisht edhe kësaj prove për shkak se e njëjta është nxjerrë në pajtim me rregullativën përkatëse së ZRRE-së. Po ashtu, faktet që vërtetohen nga kjo provë, vërtetohen edhe me provat tjera, ashtu që kjo provë nuk është në kundërshtim me provat tjera të administruara.

Gjykata vendosi ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për faktin se sipas vlerësimit të saj, në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material me dashje dhe atë me fajin e të paditurit. Ky faj është vërtetuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, e cila edhe ka përcaktuar saktë se cili është dëmi që e ka shkaktuar i padituri në raport me paditësen. Ky vlerësim i gjykatës bazën juridike e ka në nenin 136.1 të LMD-së, ku parashihet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Ndërsa sipas nenit 140 të LMD-së, përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”*

Me vetë faktin e ekzistimit të aktgjykimit të plotfuqishëm penal i cili është *res judicata*, prej të cilit vërtetohet vlera e dëmit të shkaktuar por edhe forma e fajësisë, e ka bindur gjykatën që duhet ta aprovojë këtë kërkesëpadi. Kjo për faktin se sipas nenit 14 të LPK-së, thuhet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Sa i përket lartësisë së dëmit, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se vlera e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nga ana e të paditurit është

4,712 KW/h, e që në vlerë monetare ky shfrytëzim është në vlerën 280.78 euro. Deri te ky vlerësim gjykata erdhi duke u bazuar në kalkulimin e kryer nga paditësja, i cili kalkulim është i bazuar në Rregulloren për Procedurën për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike konkretisht nenin 14 të kësaj rregullore, e cila rregullore është e miratuar nga ZRRE.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136.1, dhe 140 të LMD-së, nenit 2.1, 2.2, 8, 14, 7.1, 7.3, 356 të LPK-së, i plotësuar me nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik dhe 451.3 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.578/20, me datë 14.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahamni

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.